

**VENDIM**  
**Nr. 756, datë 16.9.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMI NR. 503, DATË 1.8.2007, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET FUNKSIONALE**  
**TË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 503, datë 1.8.2007, të Këshillit të Ministrave, tarifa e shërbimit “Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt” ndryshohet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

Tabela nr. 1

	<b>Shërbimi</b>	<b>Tarifa në lekë</b>
<b>11</b>	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 1 fletë deri në 20 fletë	100
<b>11/1</b>	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 21 fletë deri në 100 fletë	500
<b>11/2</b>	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, mbi 100 fletë.	1000